



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



## Raport Konsultativ

# Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar

### DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE për të informuar publikun dhe për të marrë komente nga palët e interesit. Raporti nuk paraqet Vendim nga ZRRE-ja dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

17 janar 2022



## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>5</b>
<b>2</b>	<b>Trendet e çmimeve dhe efekti i tyre në koston e blerjes së energjisë .....</b>	<b>5</b>
2.1	Trendet e çmimeve në tregjet evropiane të energjisë elektrike .....	6
2.2	Efekti në Furnizuesit e Shërbimit Universal në koston e blerjes së energjisë .....	7
<b>3</b>	<b>Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për sektorin e rregulluar .....</b>	<b>8</b>
3.1	Supozimet për llogaritjen e MAR të kompanive të licencuara .....	8
3.1.1	Balanca e energjisë .....	8
3.1.1	Importi i energjisë elektrike .....	9
3.2	Të Hyrat Maksimale të Lejuara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) .....	11
3.3	Të Hyrat Maksimale të Lejuara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) .....	13
3.4	Të Hyrat Maksimale të Lejuara të Furnizuesit të Shërbimit Universal (KESCO) .....	15
3.5	Faktorët e tjerë që kanë ndikuar në vlerën e të hyrave të lejuara .....	16
3.5.1	Detyrimet e mbetura të KEK ndaj konsumatorëve .....	16
3.5.2	Kostot e lejuara për shërbime ndihmëse 2007-2010 .....	16
3.5.3	Devijimet e palëve në raport me nominimet .....	16
3.5.4	Subvencionet nga qeveria e Kosovës (2021) .....	16
3.5.5	Korrigjimi i ndryshimit ndërmjet kostove dhe të hyrave .....	16
3.5.6	Ndryshimi i parametrave hyrës .....	16



## Përmbledhje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për kompanitë e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike. Shqyrtimet e jashtëzakonshme të tarifave kërkojnë një ndërhyrje rregullatore për përditësimin e parametrave tarifor për t'u siguruar që të ardhurat e lejuara të mbuluara përmes tarifave të miratuara të mbulojnë plotësisht kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimit për konsumatorët e rregulluar. Në kuadër të këtij procesi, ZRRE do të përditësojë të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) e Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe do të rregullojë HLM e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), bazuar në shifrat e përcaktuara në këtë proces. Ky raport konsultativ paraqet vlerësimin e ZRRE-së për ndikimin e Rishikimit të Jashtëzakonshëm të HLM të operatorëve të rregulluar në tarifën e konsumatorëve fundor.

## Komentet e Palëve të Interesit

ZRRE beson fuqimisht se konsultimi publik është në qendër të politikave efektive rregullatore. ZRRE-ja u ofron kompanive të rregulluara dhe konsumatorëve mundësinë që të shqyrtojnë të dhënat dhe qëndrimet e paraqitura në këtë raport konsultativ, me të cilat ata mund të mos pajtohen, dhe të komentojnë ato duke korrigjuar një gabim faktik, duke paraqitur kundër argumente ose duke ofruar të dhëna të reja të cilat ZRRE-ja mund të mos i ketë marrë parasysh. Palët që dëshirojnë të shprehin mendimet e tyre për qëndrimin e ZRRE-së ftohen t'i dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në adresën [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org), jo më vonë se 31 janar 2022, në ora 16:00. Përndryshe, komentet përmes korrierit mund të dërgohen në adresën:

Zyra e Rregullatorit për Energji

Departamenti për Tarifa dhe Çmime

Rr. Bekim Fehmiu (ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2

Prishtinë, 10000, Kosovë

## Dokumentet relevante

Rregulla për përcaktimin e të hyrave për Furnizuesit e Shërbimit Universal (Rregulla për Caktimin e Çmimeve të FSHU-së)	<a href="http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20Vendosjen%20e%20te%20Hyrave%20per%20Furnizuesin%20me%20Sherbim%20Universal%20(%20Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20FSHU).pdf">http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20Vendosjen%20e%20te%20Hyrave%20per%20Furnizuesin%20me%20Sherbim%20Universal%20(%20Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20FSHU).pdf</a>
Rregulla për të hyrat e lejuara maksimale për operatorin e sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për të hyrat e OST/OT -së)	<a href="http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20OST_OT.pdf">http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20OST_OT.pdf</a>
Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të shpërndarjes	<a href="http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20OSSH.pdf">http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20OSSH.pdf</a>
Aplikim për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OSSH/Aplikimi%20per%20Shqyrtim%20te%20Jashtezakonshem%20te%20te%20Hyrave%20te%20Lejuara%20Maksima..._1.pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OSSH/Aplikimi%20per%20Shqyrtim%20te%20Jashtezakonshem%20te%20te%20Hyrave%20te%20Lejuara%20Maksima..._1.pdf</a>



Aplikim për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSh	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OSSH/Aplikimi%20per%20Shqyrtim%20te%20Jashtezakonshem%20te%20Hyrave%20te%20Lejuara%20Maksima..._0.pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OSSH/Aplikimi%20per%20Shqyrtim%20te%20Jashtezakonshem%20te%20Hyrave%20te%20Lejuara%20Maksima..._0.pdf</a>
Aplikacioni i KOSTT për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/211223_KOSTT_Aplikacioni%20p%C3%ABr%20Shqyrtimin%20e%20Jasht%C3%ABzakonsh%C3%ABm%20e%20t%C3%AB%20Hyrave%20t%C3%AB.....pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/211223_KOSTT_Aplikacioni%20p%C3%ABr%20Shqyrtimin%20e%20Jasht%C3%ABzakonsh%C3%ABm%20e%20t%C3%AB%20Hyrave%20t%C3%AB.....pdf</a>
Shkresa e ZRrE lidhur me shqyrtimin e jashtëzakonshëm	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Shqyrtim%20i%20Jashtezakonshem%20i%20Te%20Hyrave%20te%20Lejuara%20maksimale%20per%20Operator....pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Shqyrtim%20i%20Jashtezakonshem%20i%20Te%20Hyrave%20te%20Lejuara%20maksimale%20per%20Operator....pdf</a>
Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara KEDS 2021-2022 – Përgjigjet ndaj Komenteve	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/Raport%20perfundimtar%20me%20pergjigje_MAR%20KEDS%202021.pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/Raport%20perfundimtar%20me%20pergjigje_MAR%20KEDS%202021.pdf</a>
Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara KOSTT 2021-2022 – Përgjigjet ndaj Komenteve	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/Raport%20perfundimtar%20me%20pergjigje_MAR%20KOSTT%202021.pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/Raport%20perfundimtar%20me%20pergjigje_MAR%20KOSTT%202021.pdf</a>
Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal, Përgjigjet ndaj Komenteve	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/Raport%20perfundimtar%20me%20pergjigje_MAR%20KESCO%202021.pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/Raport%20perfundimtar%20me%20pergjigje_MAR%20KESCO%202021.pdf</a>
Shqyrtimi Periodik për të Hyrat Maksimale të Lejuara KEDS	<a href="http://ero-ks.org/2018/Raportet/Pergjigje%20ndaj%20komenteve%20te%20KEDS_PRR2_final.pdf">http://ero-ks.org/2018/Raportet/Pergjigje%20ndaj%20komenteve%20te%20KEDS_PRR2_final.pdf</a>
Shqyrtimi Periodik për të Hyrat Maksimale të Lejuara KOSTT	<a href="http://ero-ks.org/2018/Raportet/Pergjigje%20ndaj%20komenteve%20te%20KOSTT_PRR2_final.pdf">http://ero-ks.org/2018/Raportet/Pergjigje%20ndaj%20komenteve%20te%20KOSTT_PRR2_final.pdf</a>



## 1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji është në procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm të tarifave për aktivitetet në sektorin e energjisë elektrike. Shqyrtimet e Jashtëzakonshme ndodhin kur ka ndryshim në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara të parametrave të përcaktimit të tarifave, që tejkalojnë një prag materialiteti prej të paktën 5%. Rritjet e paprecedentë të çmimeve në tregjet e energjisë elektrike në Evropë kanë ndikuar në kostot e blerjes së energjisë elektrike të furnizuesit të rregulluar me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë – Furnizuesit të Shërbimit Universal, kostot e blerjes për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes - duke rritur kostot e blerjes së realizuar të importit.

Në rastin e Kosovës, kostot e blerjes së energjisë elektrike janë ndikuar nga ngjarje të tjera të rëndësishme. Së pari, të dhënat e siguruara sugjerojnë një rritje të ndjeshme të kërkesës maksimale për energji elektrike, si dhe e vëllimit të konsumit të energjisë. Përveç kësaj, ka pasur ndërprerje të konsiderueshme të prodhimit nga njësitë e TC Kosova A dhe TC Kosova B, që përkonin me kërkesën e pikut për energji elektrike, të cilat nuk ishin marrë parasysh në llogaritjen fillestare të tarifës.

Shqyrtimet e jashtëzakonshme kërkojnë një ndërhyrje rregullatore për përditësimin e parametrave tariforë në mënyrë që të sigurohet që të ardhurat që gjenerohen përmes tarifave të miratuara të mbulojnë plotësisht kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimit të rregulluar për konsumatorët. Në rrethana normale, importet e energjisë elektrike nuk përbëjnë pjesë të madhe të kostove të blerjes së energjisë elektrike në Kosovë. Megjithatë, efekti i kombinuar i rritjes së theksuar të çmimeve të importit, rritjes së kërkesës dhe e ndërprerjeve të papritura të njërive vendore të prodhimit, kanë tejkalluar pragun e materialitetit dhe aktivizon një rishikim të jashtëzakonshëm të tarifave.

Ky Raport Konsultativ paraqet qëndrimet e ZRRE-së për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave për të mbuluar ndryshimin e ndjeshëm në kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe për të rivendosur furnizimin me energji elektrike për konsumatorët. Ky raport publikohet krahas një raporti tjetër konsultativ që synon të marrë qëndrimet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së për ndryshimin e strukturës tarifore për të rritur eficientësinë e konsumit të energjisë elektrike.

Raporti Konsultativ është i strukturuar si më poshtë:

- Pjesa 2 ofron një pasqyrë të çmimeve të energjisë elektrike në tregjet evropiane dhe efektin në kostot e blerjes së energjisë me shumicë në Kosovë;
- Pjesa 3 paraqet të Hyrat Maksimale të Lejuara të propozuara nga ZRRE për sektorin e rregulluar në Kosovë;
- Të dhënat mbështetëse për llogaritjet e ZRRE-së janë referencuar në këtë raport.

## 2 Trendet e çmimeve dhe efekti i tyre në koston e blerjes së energjisë

Kjo pjesë e raportit konsultativ ofron një përmbledhje të niveleve të çmimeve dhe trendeve në tregjet evropiane të energjisë. Përderisa qëllimi i kësaj pjese nuk është të identifikojë shkaqet e krizës energjetike




në Evropë, ZRRE-ja e konsideron të nevojshme të identifikojë faktorët kryesorë që qëndrojnë prapa rritjes së çmimit dhe ndikimet e tyre në kostot e blerjes së energjisë elektrike në Kosovë.

## 2.1 Trendet e çmimeve në tregjet evropiane të energjisë elektrike

Gjysma e dytë e vitit 2021 u karakterizua me një rritje të shpejtë të çmimeve në tregjet evropiane të energjisë. Gjetjet e hulumtimeve të kryera në Evropë sugjerojnë se kjo është nxitur nga një numër faktorësh. Rritja e kërkesës për gaz natyror nga Azia dhe rezervat e ulëta të stoqeve në Evropë çuan në një rritje të ndjeshme të çmimeve të gazit natyror<sup>1</sup>. Meqenëse termocentralet me gaz janë zakonisht termocentralet marginale që nevojiten për të mbuluar kërkesën në tregjet e energjisë elektrike, rritja e çmimeve të gazit natyror rezultoi në një rritje të ngjashme të çmimeve të energjisë elektrike. Studimet identifikojnë faktorë të tjerë të rëndësishëm si rritja e kërkesës së përgjithshme për energji që ka të bëjë me rimëkëmbjen nga pandemia COVID-19, të cilat gjithashtu kontribuuan në rritjen e çmimeve.

**Figura 1** Çmimet DAM (një-ditë-para) në Bursën Energjetike të Hungarisë (burimi-HUPX)

Average prices – çmimet mesatare      % increase from 1<sup>st</sup> week - % e ngritjes nga java e parë



Efekt i kombinuar i këtyre faktorëve rezultoi në një rritje të paprecedentë të çmimit të energjisë elektrike në tregjet evropiane të energjisë. Çmimi mesatar javor i Tregut një-ditë-para në Bursën Hungareze të Energjisë (HUPX), një treg i referuar zakonisht për rajonin për shkak të likuiditetit dhe afërsisë gjeografike, arriti në 376,44 EUR/MWh në javën e 51-të të 2021. Krahasuar me mesataren për javën e parë të vitit 2021 (62.02 EUR/MWh), kjo paraqet një rritje prej 563%. Rritje të ngjashme pati në bursa të tjera

<sup>1</sup> Publikimi i REKK për faktorët prapa çmimeve të gazit natyror:

[https://rekk.hu/downloads/academic\\_publications/rekk\\_policybrief\\_en\\_2021\\_08.pdf](https://rekk.hu/downloads/academic_publications/rekk_policybrief_en_2021_08.pdf)



evropiane të energjisë, ku shumica e parashikimeve sugjerojnë se nivelet e çmimeve ka gjasa të mos bien ndjeshëm para fundit të tremujorit të parë të 2022.

## 2.2 Efekti në Furnizuesit e Shërbimit Universal në koston e blerjes së energjisë

Si një importues neto i energjisë, Kosova është ndikuar edhe nga rritja e çmimeve evropiane të energjisë elektrike. Kostot e realizuara të blerjes së energjisë me shumicë të Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) ishin dukshëm më të larta se kostot e lejuara nga ZRRE, si dhe projeksioni i kërkuar nga vetë FSHU.


**Figura 2** Krahasim i parashikimit dhe koston aktuale mujore të importit

Kosovo actual – realizimi

ERO allowed – të lejuara nga ZRRE

KESCO Forecast - parashikimi nga KESCO

HU Average Prices – çmimet mesatare të HUPX



Ndryshimi në mes të kostove të parashikuara dhe të realizuara të importit është paraqitur në Figurën 2. Kostoja e propozuar e ZRRE-së për importet e përfshira në tarifa, bazuar në parashikimet e çmimeve në gusht, ishte 90 EUR/MWh për muajt e mbetur të vitit. Parashikimi i vetë Furnizuesit të Shërbimit Universal varionte midis 125 EUR/MWh dhe 143 EUR/MWh. Kostot aktuale të blerjes së energjisë në nëntor arritën në 322.87 euro, që përbën një rritje prej 257% krahasuar me parashikimin e ZRRE-së, e përfshirë në tarifat aktuale dhe një rritje prej 142% krahasuar me parashikimin e Furnizuesit të Shërbimit Universal.

Kjo është reflektuar në një ndryshim të ndjeshëm në mes të kostove të lejuara të blerjes së energjisë së importit dhe atyre të realizuara nga sektori.



### 3 Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për sektorin e rregulluar

Kjo pjesë e Raportit Konsultativ paraqet propozimin e ZRrE-së për të Hyrat Maksimale të Lejuara (HLM) për periudhën 1 shkurt 2022 – 31 mars 2023. Shqyrtimi i jashtëzakonshëm tarifor nuk ka ndikim në vlerësimin e parametrave të kostove fikse të kompanive të licencuara dhe fokusohet në rivlerësimin e balancës së energjisë, vëllimit të energjisë së importuar dhe kostot e blerjes së energjisë nga importi. Kjo pjesë e Raportit Konsultativ është strukturuar si vijon:

- Nën-pjesa 3.1 paraqet supozimet dhe vlerat hyrëse për llogaritjen e të hyrave maksimale të lejuara për kompanitë e licencuara;
- Nën-pjesa 3.2 paraqet të Hyrat Maksimale të Lejuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT);
- Nën-pjesa 3.3 paraqet të Hyrat Maksimale të Lejuara për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS);
- Nën-pjesa 3.4 paraqet të Hyrat Maksimale të Lejuara për Furnizuesin e Shërbimit Universal (KESCO).

#### 3.1 Supozimet për llogaritjen e MAR të kompanive të licencuara

##### 3.1.1 Balanca e energjisë

Balanca e energjisë për qëllime të llogaritjes së të hyrave maksimale të lejuara të sektorit të energjisë është llogaritur si vijon:

- Në nivel gjenerimi, balanca e energjisë është përditësuar në bazë të vlerësimeve të reja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) lidhur me disponueshmërinë e kapaciteteve gjeneruese, e cila i është komunikuar ZRrE-së më 16 janar 2022.
- Gjenerimi nga njësiti e tjera gjeneruese (BRE-të, energjia nga era, solare dhe hidrocentralet) është bazuar në versionin punues të Balancës së Energjisë të Ministrisë së Ekonomisë;
- Vëllimi i humbjeve në nivel transmisioni është bazuar në përqindjen e lejuar të humbjeve në rrjetin e transmisionit, e përcaktuar gjatë shqyrtimit periodik të periudhës ekzistuese tarifore;
- Niveli i humbjeve në nivel të shpërndarjes është bazuar në përqindjen e lejuar të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, e përcaktuar gjatë shqyrtimit periodik të periudhës ekzistuese tarifore;





- Shitjet e energjisë elektrike ndaj konsumatorëve fundorë në të gjitha nivelet e tensionit janë bazuar në parashikimin e Balancës së Energjisë të Ministrisë së Ekonomisë (version pune, i pa-aprovuar).
- Importi për nevoja të Furnizuesit të Shërbimit Universal është llogaritur duke para supozuar se prodhimi vendor së pari alokohet për të mbuluar konsumin e FSHU-së. Vlera totale e importit, pas alokimit të nevojës për FSHU, është shpërndarë për KEDS-in dhe KOSTT-in për mbulimin e humbjeve të këtyre operatorëve, proporcionalisht me nivelin e tyre të humbjeve.

Një përmbledhje e parametrave kryesorë të balancës së energjisë të përdorur për llogaritje të të Hyrave Maksimale të Lejuara është dhënë në tabelën në vijim:

**Tabela 1** Balanca e Energjisë e përdorur për llogaritje të MAR

Balanca e Energjisë	Njësia	2022
<b>Prodhimi</b>	<b>GWh</b>	<b>6,149</b>
TC Kosova A	GWh	2,114
TC Kosova B	GWh	3,397
Centrale me erë	GWh	382
Hidrocentrale	GWh	242
Centrale solare	GWh	14
<b>Kërkesa për furnizimin e konsumatorëve të rregulluar</b>	<b>GWh</b>	<b>5,870</b>
Kërkesa për konsumatorët e FSHU-së	GWh	4,820
Humbjet e lejuara në OSSh	GWh	923
Humbjet e lejuara në OST	GWh	127
<b>Importi gjithsejtë</b>	<b>GWh</b>	<b>583</b>
Importi për konsumatorët e FSHU	GWh	171
Importi për humbjet e lejuara në OSSh	GWh	361
Importi për humbjet e lejuara në OST	GWh	51

### 3.1.1 Importi i energjisë elektrike

Kostoja e importit paraqet kosto që bartet për Furnizuesin e Shërbimit Universal, dhe është pjesë e kostove të blerjes së energjisë për humbje për KEDS dhe KOSTT. Përcaktimi i kostos së blerjes së energjisë prej importit kërkon vlerësimin e vëllimit të nevojshëm për të mbuluar kërkesën vendore dhe çmimit të energjisë së importuar.

Vëllimi i energjisë së importuar si dhe çmimi i kësaj energjie konsiderohen të jenë në masë të madhe jashtë operatorit të licencuar. Vëllimi varet nga disponueshmëria e kapaciteteve vendore gjeneruese, prodhimi nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe nga kërkesa e konsumatorëve për energji, ndërsa çmimet e importit varen nga vlera e energjisë në tregjet ndërkombëtare.

Rregullat për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara të Furnizuesit për Shërbimin Universal parasheh përditësim vjetor të kostove për të reflektuar ndryshimet në mes të vlerës së supozuar dhe asaj



të realizuar të blerjes së energjisë, në mënyrë simetrike. Në rastet kur kostoja e blerjes së energjisë nga importi është më e ulët se kostot e lejuara nga ZRrE, ndryshimi kompensohet me interes në vitin vijues, dhe anasjelltas.

Kostoja e blerjes së energjisë nga importi, e përdorur për llogaritjen e të hyrave maksimale të lejuara për KESCO, KEDS dhe KOSTT, është vlerësuar si në vijim:

- Vëllimi i importit për nevoja të Furnizuesit të Shërbimit Universal është llogaritur duke para supozuar se prodhimi vendor së pari alokohet për të mbuluar konsumin e FSHU-së. Vlera totale e importit, pas alokimit të nevojës për FSHU, është shpërndarë për KEDS-in dhe KOSTT-in për mbulimin e humbjeve të këtyre operatorëve, proporcionalisht me nivelin e tyre të humbjeve;
- Kostoja e parashikuar për blerjen e energjisë nga importi është bazuar në dy burime kryesore – të dhënat e publikuara nga European Energy Exchange (*EEX-PXE Hungarian Power Futures*) për çmimet mujore që kanë rezultuar më 13 janar 2022<sup>2</sup> dhe që kanë qenë burim primar i përcaktimit të kostos së importit për muajt janar-korrik 2022; dhe raportin e Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) lidhur me vlerësimin preliminar të çmimeve të energjisë në Evropë, që përmban parashikimin për çmimet e energjisë në tregjet evropiane me shumicë<sup>3</sup>;
- Çmimet mujore të energjisë së importit janë përcaktuar si vijon:
  - Për muajt për të cilët ekzistojnë të dhëna faktike për çmimet e energjisë e që burojnë nga EEX, është marrë vlera e energjisë e cila ka figuruar në portalin e bursës së energjisë EEX;
  - Për muajt për të cilët nuk ekzistojnë të dhënat më lartë, çmimet mujore janë llogaritur duke marrë parasysh trendin e parashikuar në raportin e ACER, por të reflektuar mbi të dhënat faktike të marra nga EEX, duke u bazuar në muajin e fundit për të cilin këto të dhëna janë publikuar (korrik 2022).
  - Kështu, për shembull, nëse çmimi i importit në raportin e ACER për muajin dhjetor 2022 është 1.217 herë më i lartë krahasuar me çmimin në korrik, atëherë çmimi në dhjetor i përcaktuar për llogaritje të MAR është 1.217 herë vlera e çmimit të rezultuar nga të dhënat e EEX.

---

<sup>2</sup> Burimi: European Energy Exchange - <https://www.eex.com/en/market-data/power/futures/#%7B%22snippetpicker%22%3A%22EEX-PXE%20Hungarian%20Power%20Futures%22%7D>


<sup>3</sup> ACER: Preliminary assessment of Europe's high energy prices and the current wholesale electricity market design [https://extranet.acer.europa.eu/official\\_documents/acts\\_of\\_the\\_agency/publication/acer's%20preliminary%20assessment%20of%20europe's%20high%20energy%20prices%20and%20the%20current%20wholesale%20electricity%20market%20design.pdf](https://extranet.acer.europa.eu/official_documents/acts_of_the_agency/publication/acer's%20preliminary%20assessment%20of%20europe's%20high%20energy%20prices%20and%20the%20current%20wholesale%20electricity%20market%20design.pdf)



- Çmimet e energjisë në bursa ndërkombëtare nuk përfshijnë kostot e kapaciteteve transmetuese për bartjen e kësaj energjie deri në tregun vendor. Për këtë arsye, çmimi i parashikuar i importit duhet të përfshijë edhe një lejesë për të reflektuar këto kosto.

Një përmbledhje e kostos së energjisë së importit të përdorur për qëllime të të Hyrave Maksimale të Lejuara është dhënë në grafikun në vijim.

**Tabela 2** Çmimi i importit në llogaritjen e të Hyrave Maksimale të Lejuara të të licencuarve



### 3.2 Të Hyrat Maksimale të Lejuara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT)

Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) janë dhënë në tabelën në vijim.

**Tabela 3** Të Hyrat Maksimale të Lejuara të KOSTT

Te hyrat e lejuara maksimale	Lejuar 2021	Propozimi KOSTT 2022	Propozimi ZRRE 2022
<b>Parametrat e indeksimit</b>			
Faktori i efikasitetit	1.5%	1.5%	
HICP		5.0%	
Euribor		-0.5%	
Faktori S		7.6%	
Norma e interesit - It		7.1%	
<b>Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes (OPMct)</b>			



Vlerësimi gjate PRR2 €m	7.09	6.99	6.99
Lejuar -OPMct = OPMct-1 * (1 + CPIt-1) * (1 – Et)* (1 – Pt) €m	<b>7.11</b>	<b>7.35</b>	<b>7.35</b>
Përshtatjet e kostove të mirëmbajtjes: €m			
Aktuali €m			
Dallimi duke aplikuar faktorin ndarës 50/50 €m			
Përshtatjet për OPEX për Vallaq €m			
<b>Kostot e zhvlerësimit (DEPct)</b>			
Vlerësimi gjate PRR2 €m	11.71	12.08	12.08
Lejuar - DEPct = DEPct-1 * (1 + CPIt-1) * (1 – Pt) €m	<b>11.74</b>	<b>12.67</b>	<b>12.67</b>
<b>Kostot e kthimit (RTNct)</b>			
Vlerësimi gjate PRR2 €m	10.85	11.09	11.09
Lejuar - RTNct = RTNct-1 * (1 + CPIt-1) * (1 – Pt) €m	<b>10.88</b>	<b>11.63</b>	<b>11.63</b>
<b>Kostot e humbjeve (LSSct)</b>			
<b>Parashikim</b>			
LSSAt	1.78%	1.78%	1.78%
REUEt GWh	6,944	7,376	7,376
WHEAt €/MWh	55.78	111.86	108.16
Kostoja e parashikuar e humbjeve €m	<b>6.54</b>	<b>13.94</b>	<b>13.48</b>
<b>Aktual</b>			
LSSAt	1.78%	1.78%	1.78%
REUEt GWh			
WHEAt €/MWh			
Kostoja aktuale e humbjeve <sup>4</sup> €m			
<b>Fondi</b>			
Parashikim €m	<b>16.98</b>	<b>10.94</b>	<b>10.94</b>
Aktual €m (vlerësimi fillestar)			
Aktual €m (vlerësimi përfundimtar)			
<b>Shërbimet e ndihmëse</b>			
Parashikim €m	<b>9.53</b>	<b>12.87</b>	<b>7.00</b>
Aktual €m			
<b>Përshtatjet</b>			
Të hyrat e parregulluara			
Parashikim €m	(0.06)	(0.06)	(0.06)
Aktual €m			
Të hyrat nga mekanizmi ITC			
Parashikim €m	(3.60)	(3.60)	(3.60)
Aktual €m			
Përshtatjet për (2017 dhe PR1)	(1.26)	(1.26)	(1.26)

<sup>4</sup> Përshtatur për ngarkesën e veriut



Te hyrat nga KEK:

Parashikim €m	(3.33)	(3.33)	(5.92)
Aktual €m			
<b>KREV – faktori korrigjues i të hyrave</b>			
Faktori korrigjues i te hyrave t-1 €m	(15.59)	(16.62)	(16.62)
AACT-1 - kostot aktuale për vitin t-1 €m			
ARRt-1 - te hyrat aktuale për vitin t-1 €m			
<b>KREvt = (AACat-1 – ARRt-1) * (1+ It) €m</b>			
<b>Te hyrat maksimale pa kostot e Fondit (Neto KOSTT)</b>	<b>28.84</b>	<b>40.55</b>	<b>32.12</b>
<b>Kostot e Fondit BRE<sup>5</sup> (neto = 16.98<sub>t</sub> – 6.88<sub>t-1</sub>)</b>	<b>10.10</b>	<b>3.98</b>	<b>3.98*</b>
<b>MAR – te hyrat e lejuara maksimale gjithsej - €m</b>	<b>38.94</b>	<b>44.53</b>	<b>35.61</b>

\*Kostot neto te Fondit për BRE janë llogaritur si diferencë e kostove të parashikuara për vitin 2022 në vlerë prej 10.94 mil€ dhe kostove të përshtatura për vitin 2021 në vlerë prej 7.02 mil€.

Shërbimet ndihmëse gjatë periudhës 2007-2010 në vlerë prej €5.9 milionë janë reflektuar në të hyrat e lejuara të KOSTT. Për të njëjtën vlerë, janë azhurnuar kostot që kanë të bëjnë me shërbimet ndihmëse për vitin 2022.

### 3.3 Të Hyrat Maksimale të Lejuara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS)

Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) janë dhënë në tabelën në vijim.

**Tabela 4 Të Hyrat Maksimale të Lejuara të KEDS**

Të hyrat e lejuara maksimale (mil€)	Njësia	Lejuar 2021	Propozimi KEDS 2022	Propozimi ZRRE 2022
<b>Parametrat e indeksimit</b>				
Faktori i efikasitetit	%	1.5%	1.5%	1.5%
Inflacioni	%		5.0%	
Euribor	%		-0.5%	
Faktori - S	%		7.6%	
Norma e interesit - It	%		7.12%	
<b>Shpenzimet operative dhe te mirëmbajtjes (OPMct)</b>				
Vlerësimi gjatë PRR2	€m	25.21	24.91	24.91
Lejuar-OPMct=OPMct-1*(1 + CPIt-1)*(1-Et)*(1-Pt)	€m	25.28	25.46	26.18
Kostot shtesë për sigurim shëndetësor	€m	0.24	0.24	0.24
<b>Kostot e zhvlerësimit (DEPct)</b>				
Vlerësimi gjatë PRR2	€m	16.17	17.55	17.55
Lejuar - DEPct = DEPct-1 * (1 + CPIt-1) * (1 - Pt)	€m	16.21	17.89	18.36
<b>Kostot e kthimit (RTNct)</b>				

<sup>5</sup> Vlera prej 6.88 është kalkuluar si = 6.41\*(1+7.3%); ku 6.41 është korrigjimi për vitin 2020, kurse 7.3% është norma e interesit



Vlerësimi gjatë MYT	€m	15.90	16.37	16.37
Lejuar - RTNCt = RTNCt-1 * (1 + CPit-1) * (1 - Pt)	€m	15.94	16.71	17.17
<b>Obligimet ndaj KOSTT-it</b>				
Obligimet ndaj KOSTT-it -parashikim	€m	1.30	1.52	1.55
Obligimet ndaj KOSTT-it – aktual	€m			
<b>Kostot e humbjeve (LSSct)</b>				
<b>Parashikim</b>				
LSSAt	€m	16.40%	15.10%	15.10%
REUet	€m	5,809	6,593.8	6,109.8
WHEAt	€/MWh	53.41	226.3	108.05
Kostoja e parashikuar e humbjeve	€m	<b>50.88</b>	<b>225.32</b>	<b>99.69</b>
<b>Aktual</b>				
LSSAt	%	16.40%	15.1%	15.1%
REUet	GWh	6,260		
WHEAt	€/MWh	84.47		
Kostoja e aktuale e humbjeve	€m	<b>86.71</b>		
<b>Përshtatjet</b>				
Te hyrat e parregulluara PRR2	€m	(3.50)	(3.50)	(3.50)
Përshtatjet për PRR1	€m	(1.50)	(1.50)	(1.50)
Te hyrat aktuale te parregulluara	€m			
Taksa e licencës:				
Parashikim	€m	0.17	0.17	0.08
Aktual	€m			
<b>KREV – faktori korrigjues i të hyrave</b>				
Faktori korrigjues i te hyrave t-1	€m	(14.44)	18.19	16.24
AAct-1 - kostot aktuale për vitin t-1	€m	121.02	121.85	
ARRt-1 - te hyrat aktuale për vitin t-1	€m	105.86	104.90	
<b>KREvt = (AAct-1 – ARRt-1) * (1+ It)</b>	€m	<b>16.29</b>		
<b>MAR – të hyrat e lejuara maksimale</b>				
	€m	<b>90.51</b>	<b>300.53</b>	<b>174.50</b>



### 3.4 Të Hyrat Maksimale të Lejuara të Furnizuesit të Shërbimit Universal (KESCO)

Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU) janë dhënë në tabelën në vijim:

*MAR për furnizuesin e shërbimit universal*

MAR-i i Furnizuesit me Shërbim Universal	Njësia	Lejuar 2021	Aplikimi FSHU 2022*	Propozimi ZRRE 2022
<b>Parametrat e indeksimit</b>				
Norma e interesit It (t-1)	%	6.85%		5.53%
<b>Kostot me pakice te furnizuesit</b>				
OPEX - $OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	4.6	5.29	5.29
Korrigjimi për OPEX te vitit 2020 dhe 2021	€m			0.42
Zhvierësimi - $DEPCT = DEPCT-1 * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.1	0.1	0.1
<b>Kostot e bartshme</b>				
Kostot e OST	€m	17.8	26.24	18.34
Kostot e OSSh	€m	90.5	145.05	174.50
Kostot për fondin e BRE	€m	9.9	14.45	3.54
<b>Kapitali punues (WCLCt)</b>				
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETRt + WHPCT + PSTCt - NTFRt)$	€m	1.5	2.48	2.22
<b>Kostot për blerjen e energjisë</b>				
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	147.2	242.22	186.10
<b>Taksa për licencë</b>				
Taksa për licencë	€m	0.03	0.07	0.07
<b>Borxhi i keq (BDTA)</b>				
BDTA	%	4%	4%	4%
BDTA	€m	11.6	19.18	12.52
<b>Përshtatjet e të hyrave për FSHU</b>				
Përshtatjet e vitit 2021	€m	6.8	24.37	43.56
<b>Të hyrat e lejuara maksimale</b>	<b>€m</b>	<b>290.14</b>	<b>479.45</b>	<b>446.67</b>

\*Shënim: Në aplikacionin e tyre, KESCO/FSHU nuk ka përfshirë të gjitha kostot e bartshme të KEDS/OSSH-së në vlerë prej 300mil€, por vetëm kostot në vlerë prej 145mil€. Po ashtu KESCO/FSHU pas aplikimit fillestar, KESCO/FSHU ka dërguar në ZRRE edhe informata shtesë të përditësuara lidhur me kostot e devijimeve, të hyrat e azhurnuara nga faturimi lidhur me subvencionin, si dhe kostot e azhurnuara për muajin dhjetor për blerjet e energjisë me shumicë.



### **3.5 Faktorët e tjerë që kanë ndikuar në vlerën e të hyrave të lejuara**

Kjo pjesë e raportit konsultativ përmbledhë përshtatjet e të hyrave të lejuara që nuk përfshihen në përshtatjet e zakonshme të të hyrave të përfshira në tabelat e HLM.

#### **3.5.1 Detyrimet e mbetura të KEK ndaj konsumatorëve**

Detyrimet e mbetura të KEK-ut ndaj konsumatorëve për kthimin e lejuar dhe zhvlerësimin për investimet që nuk i kanë realizuar, janë alokuar tërësisht në tarifat e KOSTT në vlerë prej 5.9 milionë €.

#### **3.5.2 Kostot e lejuara për shërbime ndihmëse 2007-2010**

Ndryshimi në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara për shërbimet ndihmëse gjatë periudhës 2007-2010 në vlerë prej 5.9 milionë€ janë reflektuar në të hyrat e lejuara të KOSTT. Për të njëjtën vlerë, janë azhurnuar kostot që kanë të bëjnë me shërbimet ndihmëse për vitin 2022.

#### **3.5.3 Devijimet e palëve në raport me nominimet**

Gjatë muajit dhjetor, Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU - KESCO) ka nën-nominuar në mënyrë konsistente në raport me konsumin e tyre dhe, si rezultat, sistemi elektroenergjetik i Kosovës ka tërhequr në mënyrë të pa-autorizuar energji elektrike nga sistemet fqinje.

Për këtë energji të tërhequr në mënyrë të pa-autorizuar, KOSTT ka vlerësuar se kostoja që i faturohet FSHU për devijimet e shkaktuara është €17 milionë dhe në këtë kosto përfshihet edhe faktori penalizues për devijimin prej 1.3 aplikuar në kostot e imbalancës, që reflekton faktin se nuk është aktivizuar oferta për të mbuluar devijimet. Duke pasur parasysh se FSHU ka devijuar në mënyrë sistematike dhe të qëllimshme, ZRRE nuk do të përfshijë në tarifë penalltinë që duhet të paguajë FSHU. Ndikimi i penalltisë do të mbulohet nga FSHU dhe nuk do të bartet nga konsumatorët.

#### **3.5.4 Subvencionet nga qeveria e Kosovës (2021)**

Të Hyrat Maksimale të Lejuara janë përshtatur për të reflektuar subvencionin që është alokuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në dhjetor të vitit 2021 në vlerë prej 20 milionë €.

#### **3.5.5 Korrigjimi i ndryshimit ndërmjet kostove dhe të hyrave**

Të gjitha dallimet ndërmjet të hyrave aktuale dhe kostove aktuale për vitin 2021 dhe në harmoni me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale janë reflektuar në vitin vijues 2022 për secilin të licencuar të rregulluar.

#### **3.5.6 Ndryshimi i parametrave hyrës**

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në mbledhjen e mbajtur më 14 janar 2021, ka aprovuar parametrat e ri hyrës për llogaritjen e tarifave të Furnizuesit të Shërbimit Universal. Ky vendim ka aprovuar parametrat hyrës si vijon:

- Marzha me pakicë e aplikuar në kostot e blerjes së energjisë me shumicë, është reduktuar nga 3% në 2.54%;





- Borxhi i Keq është reduktuar nga 4% në 2.4%; dhe,

Përveç këtyre ndryshimeve, ZRrE ka aprovuar edhe shpenzimet operative dhe faktorin e efikasitetit, të cilat kanë ndikuar në nivelin e të hyrave të lejuara të të licencuarve. Parametrat e ri hyrës aplikohen për 9 nga 12 muajt e vitit pasardhës tarifor.